

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mikroekonomia I
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-rë
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Sipas orarit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Florentina Xhelili Krasniqi
Detajet kontaktuese:	florentina.xhelili@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me bazat e teorisë mikroekonomike dhe me mënyrën ekonomike të të menduarit. Lënda përfshin temat lidhur me Kufirin e mundësive të prodhimit dhe konceptet bazë mbi funksionimin e ekonomisë së tregut; Kërkesën, ofertën dhe ekuilibrin; Elasticitetin e kërkesës dhe të ofertës, Zgjedhjen konsumatore dhe kërkesën; Teorinë e prodhimit dhe të produktit marxhinal; Analizën e kostove; Strukturat e tregut si Konkurrenca e plotë, Monopoli, Konkurrenca monopoliste dhe Oligopoli; Shpërndarjen e të ardhurave dhe tregun e faktorëve të prodhimit si dhe Eksternalitetet dhe Sektorin publik.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të kuptojnë konceptet bazë mikroekonomike;• Të kuptojnë vendimmarrjen ekonomike dhe lidhur me këtë analizën marxhinaliste dhe kostot oportune;• Të fitojnë njohuri për natyrën dhe funksionimin e tregjeve të produkteve;• Të fitojnë njohuri për natyrën dhe funksionimin e tregjeve të faktorëve të prodhimit;• Të kuptojnë “dështimin e tregut” dhe rolin e qeverisë;• Të ndërtojnë, interpretojnë dhe analizojnë grafikët dhe të dhënat për të përshkruar dhe shpjeguar konceptet ekonomike.

	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë zbatimin e teorisë në problemet praktike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë konceptet ekonomike si pamjaftueshmëria, kosto oportune dhe analiza marxhinale; • të kuptojë rëndësinë dhe rolin e çmimeve në një ekonomi tregu; • të përdorë konceptet e elasticitetit të kërkesës dhe të ofertës për të vlerësuar në mënyrë sasiore situatat ekonomike; • të kuptojë kostot e prodhimit të një firme dhe lakoret e kostove; • të shpjegojë dhe të tregojë grafikisht se si firmat marrin vendime lidhur me prodhimin dhe çmimet në secilën prej strukturave të tregut; • të kuptojë se çfarë e përcakton ofertën në tregjet konkurruese dhe në tregjet jokonkurruese; • të kuptojë “dështimin e tregut” dhe rolin e qeverisë; • të demonstrojë aftësi për të ofruar zgjidhje për probleme të ndryshme ekonomike.
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Në javë, studentët vijojnë tri orë ligjërata dhe dy orë ushtrime. Gjatë ligjëratave studentët prezantojnë punën e tyre dhe angazhohen në diskutime. Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave dhe diskutimeve interaktive, punës individuale apo grupore rreth çështjeve specifike dhe prezantimeve të punimeve seminarike.</p> <p>Konsultimet me studentë ofrohen në orarin e përcaktuar</p>
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Testi i ndërmjetëm: 40% • Pjesmarrja aktive në klasë: 10% • Punimi seminarik dhe prezantimi: 10% • Provimi final: 40%
Literatura	
Literatura bazë:	Paul A. Samuelson & William D. Nordhaus, <i>Economics</i> , McGrawHill/Irvin (Botim i

	përkthyer në gjuhën shqipe, 2022).
Literatura shtesë:	Florentina Xhelili Krasniqi, Strukturat e tregut, IFK, Prishtinë N. Gregory Mankiw & Mark P. Taylor, Ekonomiksi, Mikroekonomia, UET Press. Ramiz Livoreka, Parimet e mikroekonomisë, Prishtinë; Ahmet Maçellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, Hyrje në Ekonomi, Shtëpia Botuese “PEGI” Tiranë; John Sloman, Microeconomics; Artikuj nga interneti, revistat dhe shtypi.

Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Tema
Java e parë:	Prezantimi i Syllabus-it
Java e dytë:	Konceptet bazë të Ekonomiksit; Leximi dhe ndërtimi i grafikëve
Java e tretë:	Kërkesa, oferta, ekuilibri i tregut
Java e katërt:	Elasticiteti i kërkesës dhe i ofertës
Java e pestë:	Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa
Java e gjashtë:	Firmat
Java e shtatë:	Testi i ndërmjetëm
Java e tetë:	Teoria e Prodhimit dhe e Produktit Marxhinal
Java e nëntë:	Kostoja
Java e dhjetë:	Konkurrenca e Plotë
Java e njëmbëdhjetë:	Monopoli
Java e dymbëdhjetë:	Konkurrenca Monopolistike dhe Oligopoli
Java e trembëdhjetë:	Tregu i faktorëve të prodhimit
Java e katërbëdhjetë:	Eksternalitetet dhe sektori publik
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i punimeve seminarike

--	--

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet të respektojnë kodin e sjelljes gjatë ligjëratave dhe provimeve dhe në komunikim me stafin akademik.